

VENDIM
Nr. 407, datë 3.6.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI I VARREZAVE TË FSHATIT QERRET”, BASHKIA KAVAJË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave të fshatit Qerret”, Bashkia Kavajë.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Kavajë.
 3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 658 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 658 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Kavajë.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Kavajë.
 6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
 7. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Kavajë.
 8. Bashkia Kavajë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
 9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Kavajë.
 10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës–Kavajë–Krujë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Kavajë për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.
 11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Kavajë për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.
 12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Kavajë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës–Kavajë–Krujë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Durrës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Edi Rama

Nr. rendor	Pronari			Të dhëna kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)				Të dhënat për shpronësim			Vlera totale (lekë)	Shënime (kufizime hipotekore barre mbi pasurinë etj.)
	Emër	Atësi	Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m²)	Sipërfaqja e shpronësimit (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (m²)		
1	Sherife Hasan Xherahi Vladimir Vath Xherahi Flamur Vath Xherahi Dallandyshe Nezir Xherahi Lorenzo Vladimir Xherahi Leonardo Vladimir Xherahi Lume Vath Sinameta Bujar Vath Xherehi Gjyrsyme Vath Ibra Makbule Vath Skenderi Deprime Vath Ibra Lirie Vath Tosku			3691	110/18	Arë	10950	2,000	329	658,000	658,000	Seksioni E - “ Vjen nga ndarja e pasurisë 110/1 sipas dokumentit 0011. Pasuri e pacertifikuar”.
VLERA TOTALE											658,000	